



Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani është pedagoge me kohë të plotë në fushën e së drejtës publike në Fakultetin e Drejtësisë, Universitetin e Tiranës (UT) që nga viti 1998. Po ashtu, ka një angazhim të gjatë pranë Institutit të Studimeve Europiane, UT dhe Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë.

Ka kryer studime universitare pranë Universitetit të Leyden, Hollandë, studime pasuniversitare LL.M. në të Drejtën e Krahasuar Kushtetuese në Universitetin e New York School, SHBA/CEU, Budapest, Hungari, dhe studimet e doktoraturës në fushën e së drejtës publike në Universitetin e Tiranës në 2008. Në vitin 2011 fitoi titullin akademik 'Profesor i Asociuar'. Mban titullin akademik 'Profesor' që prej vitit 2015. Ka mbajtur dhe mban pozicione të ndryshme administrative në Universitetin e Tiranës.

Ka një përvojë 25 vjeçare në të drejtën publike dhe politikën publike me fokus në atë administrative, kushtetuese, dhe të drejtat e njeriut. Ka përvojë të gjerë me administratën publike në Shqipëri, përfshirë punën pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe kontributin si Këshilltare e Kryeministrit për të Drejtën Publike dhe Zëvendës Ministre e Integritit gjatë viteve 2013-2017. Njohuritë e saj për kuadrin institucional të sektorit publik dhe reformën kushtetuese dhe administrative janë të shumta, dhe përfshijnë një gamë të gjerë si reforma e administratës publike, konsultimi publik, derregullimi, transparenca, konflikti i interesave dhe antikorrupsioni, decentralizimi, barazia gjinore, etj. Ajo ka përvojë të gjerë bashkëpunimi me karakter kërkimor-shkencor dhe studimor me organizata ndërkombëtare si OSBE, UNDP, UNWOMEN, USAID, Banka Botërore, GIZ, Friedrich Ebert, Konrad Adenauer, Delegacioni i BE në Shqipëri dhe Kosovë, RESPA, SIGMA/OECD, etj., si dhe shoqërinë civile vendase.

Është autore dhe bashkëautore e një sërë botimesh, përfshirë: Fjalori i parë shqip-anglisht-shqip për të drejtat e njeriut në Shqipëri dhe Kosovë, 'E drejta administrative në vështrim krahasues', 'E drejta kushtetuese dhe administrative', 'Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Shqipërisë'. Është autore dhe bashkëautore e një game të gjerë artikujsh dhe prezantimesh në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare, simpoziume, punëtori, etj. Ka kryer hulumtime dhe studime të shumta në fushat e saj të ekspertizës, si dhe drejtuar dhe marrë pjesë në realizimin e një numri të madh projektesh me interes publik.